



"ANGERBA" sh.p.k.

RIKONSTRUKSION SHKARKUESI KATASTROFIK MALAJ-1

BASHKIA MIRDITE

PROJEKT ZBATIMI

RAPORT TEKNIK

QERSHOR 2024



ANGERBA SHPK

RELACION TEKNIK

RIKONSTRUKSION I SHKARKUESIT KATASTROFIK MALAJ-1

BASHKIA MIRDITE

I.- HYRJA

Rrethi i Mirdites ka nje siperfaqe toke te punuar prej 6228 ha, prej te cilave 5439 ha eshte toke are dhe 789 ha eshte toke me dru frutore.

Ne vitin 1990 nga kjo siperfaqe ujitej 3600 ha ; e ndare ne 1490 ha me Ujembledhesa, 1079 ha me stacione pompimi dhe 1031 ha me kanale ujites.

Pas ndryshimeve te ndodhura pas vitit 1990 siperfaqja qe ujitet eshte reduktuar mjaft. Ujitja ne sasira te vogla kryhet me ujembledhesa dhe kanale ujites. Nder Ujembledhesat kryesore te rrethit te Mirdites eshte Malaj 1.

Ujembledhesi Malaj 1 eshte ndertuar ne vitin 1973 me kapacitet ujembajtes prej 2 300 000 m³ uje. Ka nje lartesi dige prej 40 m dhe gjatesi ne kurore prej 180 ml.

Projekti fillestar i vepres i perfunduar ne vitin 1973 u rishikua disa vite me vone duke u mbingritur diga dhe me 4 m te tjera. Mbingritja u be duke u ndryshuar vetem skarpata e jashteme e trupit te diges. Kjo solli si pasoje dhe zgjatjen e ujeleshuesit me rreth 18 m.

Ne vitet 2016-2018 u nderhy ne kete objekt duke bere rehabilitimin e ujeleshuesit. U mbingrit puseta e hyrjes se ujeleshuesit. Po ashtu duke pare demtimin e tubit te ujeleshuesit me nje inspektim te kryer me kamera brenda tij u hartua projekti dhe u financua investimi nga Bashkia per futjen brenda tubit egzistues te DN 500 PN 16 (per presion mesatar) me nje diameter te jashtem prej 454 mm dhe diameter te brendshem 442 mm me gjatesi 230 ml.

Aftesia ujites e ketij ujembledhesi eshte 750 ha. Nga kjo siperfaqe 150 ha jane ne Malaj ; 200 ha per fshatrat Gurre, Tarazh i Eperm, Sifoni Guri i Zi, Bungaj ; 200 ha per Koder Rreshen dhe 200 ha per Troje e Prosek. Ujitja behej e mundur me rreth 30 km kanale ujites. Aktualisht rrjeti ujites eshte pothuajse i gjithi i rehabilituar ne tre faza me nje fond investimi prej rreth 80 000 000 leke. Eshte rehabilituar kanali kryesor ujites deri te Priza Shqash te shkolla Malaj, Dega Ujites Tene Vals dhe Dega Ujites Bungaj me gjatesi te pergjitheshme prej rreth 15.9 km. Mbetet per financim vetem faza e katert Dega Perlat me nje fond prej afro 64 000 000 leke. Gjatesia e ketij rrjeti qe mbetet per rehabilitim eshte 4.5 km. Problem per kete Ujembledhes mbetet Shkarkuesi Katastrofik. Per shkak te pellgut te madh shimbledhes aftesia shkarkuese e tij eshte 53 m³/sek per shitat me 0.3 % siguri. Ky shkarkues ne pjesen renese eshte demtuar plotesisht. Ne vite eshte nderhyre disa here per ta riparuar por nderhyrjet nuk kane patur rezultat.

II.- TE DHENA TE DETYRES SE PROJEKTIMIT

Projekt Zbatimi eshte hartuar ne baze te detyres se projektimit, hartuar nga Bashkise Mirdite.



Detyra e projektimit kerkon, qe te kryhen punime per Rikonstruksionin e Shkarkuesit Katastrofik Malaj-1.

Ne projekt te parashikohen te gjitha punimet, qe kane te bejne me rikonstruksionin e kesaj vepre anekse mjaft te rendesishme te Ujembledhesit Malaj-1.

III.- RAPORTI TOPOGRAFIK

"ANGERBA"shpk, ka kryer matjet topografike per kete nenobjekt si me poshte :

Pikat dhe koordinatat konkrete ku ne kemi vendosur bazën e GPS-it tonë janë te dhena ne planimetrite perkatese.

Saktësia e realizuar në matje me GPS-in tonë është +/- 1 cm në plan dhe +/- 1.5 cm në kuotat për një rreth me rreze 5 000 metra (ose diametër 10 000 metra). Kjo saktësi është maksimalisht e mjaftueshme për kërkesat teknike të projektit.

Në të gjithë zonen e rilevuar ne kemi vendosur disa pika të forta me gozhide betoni dhe kunjat hekuri të cilat do të shërbejnë gjatë zbatimit të projektit (pikat poligonale).

Këto pika poligonale u shfrytëzuan njëkohësisht për gjithë rlevimin e zones.

Koordinatat planimetrike dhe altimetrike të këtyre pikave janë të paraqitura në fletet përkatëse, si dhe ne nje tabele te permbledhur.

Vendi ku do te ndertohet objekti eshte ne pronesi te **Bashkise Mirdite**.

Rilevimi eshte realizuar ne kete menyre:

Si fillim qe ne momentin e pare eshte bere rikonjicioni i zones dhe eshte vendosur per menyren e kryerjes se ketij procesi. Duke menduar qe te dhenat topografike do te jene sipas rrjetit koordinativ shteteror eshte filluar me grumbullimin e materialeve te nevojshme per transformimin e te dhenave tona ne kete rrjet. Keshtu nga hartat 1:25 000 te zones jane identifikuar pikat e triangolacionit Shqiptar dhe jane marre te dhenat nga Instituti Topografik Ushtarak per keto pika si dhe listen e reperave dhe te markave ne kete zone. Me pas eshte zhvilluar nje rrjet poligonal i mbeshtetur ne keto pika dhe duke perdorur teknologjine GPS. Me nje GPS baze dhe tre recivitor GPS eshte ndertuar nje rrjet trekendeshash per te llogaritur koordinatat e pikave te poligonit ne menyren me te sakte te mundur. Llogaritja e pikave poligonale te matura me GPS per çdo pike eshte skicuar nje vizatim per te treguar vendndodhjen e pikes ne lidhje me objekte fikse dhe e shoqeruar me fotografi dixhitale, kjo do te perbej monografin e pikave poligonale.

Gjithashtu jane fiksuar ne terren pikat fikse te fillimit dhe te mbarimit te rrugeve si dhe pika te tjera te rendesishme qe jane gjykuar te domosdoshme.

Te gjitha pikat e rilevuara ne terren jane te regjistruara me kode speciale ne memoriet e brendshme te instrumentave te perdorura nga ana jone. Pikat e regjistruara ne terren jane transferuar ne kompjuter me programet e realizuara perkatesisht per kete proces. Me vone te gjitha pikat jane perpunuar dhe u be krijimi i hartes dixhitale ne shkalle reale ne kompjuter. Ne terren jane rilevuar te gjitha pikat karakteristike per te pozicionuar te gjitha detajet. Rendesit e veçante i eshte kushtuar pozicionimit te detajeve si: ndertimet e ndryshme civile, elementet e infrastruktures, (rrjeti elektrik, telefoni, ujesjelles) etj. Programi qe eshte perdorur ka te vizatuar te gjithë elementet planimetrik. Te dhenat finale jane "file" dwg si dhe nje Model i Terrenit ne forme dixhitale ne formatin DXF per projektimin e rrugeve me programet



perkatase. Te dhenat dixhitale permbajne te gjitha linjat e nderprerjes se terrenit per nje ndertim shume te mire te modelit tridimensional. Te gjitha detajet topografike jane te pranishem. Ndermjet te tjerave jane: rruge te asfaltuara dhe te pa asfaltuara, trotuare dhe kuneta, shtepi dhe mure mbajtes, peme, puseta egzistuese dhe te gjitha sherbimet e ndryshme urbane, kanale dhe rrethime siperfaqesh etj. Te gjitha pikat e matura jane te pranishme ne harten e krijuar. Izoipset jane krijuar nepermjet programit perkates.

IV.- ZGJIDHJA TEKNIKE E PROJEKTIT

Projekti do te trajtoje :

Punime per rikonstrukcionin e Shkarkuesit Katastrofik

Aktualisht aftesia shkarkuese e Shkarkuesit Katastrofik e llogaritur me 0.3 % ne projektin e ndertimit eshte 53 m³/sek.

Ne kete shkarkues eshte nderhyre disa here per rikonstrukcionin e tij por perseri ne pjesen e rrymeshpejtuesit dhe ne pusin e shuarjes kane ndodhur demtime.

Projekti ka parashikuar nderhyrje ne kete shkarkues qe ne frontin kaperderdhes qe eshte dhe segment i rruges per ne fshatin Malaj i Eperm. Do te behet me shtrese betonarme me trashesi 20 cm. Nga fillimi i shkarkuesit deri ne Pk.6 me gjatesi 51 m projekti parashikon vetem riparime te pjeseshme. Nga kjo pikete dhe deri te pusi egzistues i shuarjes ne nje segment me gjatesi 75.5 m projekti parashikon prishjen totalisht te seksionit egzistues dhe ndertimin e nje lugu betonarme. Ne te dy anet e ketij lugu do te ndertohet drenazh me granil te tipit « B ». Brenda ketij drenazhi qe do te mblidhet me gjetekstil do te vendoset tub i perforuar DN 150. Eshte parashikuar ruajtja e pusit egzistues te shuarjes duke e perforcuar ate me mure ne forme « U » betonarme. Eshte parashikuar ndertimi dhe nje pusi te ri shuarje qe do te inkastrohet detyrimisht ne formacion rrenjesor. Pas tij kemi dhe nje mbrojtje me gabiona me gjatesi 5 m.

V.- KERKESAT E SIGURIMIT TEKNIK GJATE ZBATIMIT TE PUNIMEVE TE NDERTIMIT

Gjate zhvillimit te punimeve ne objekt duhet te zbatohet rregullorja e sigurimit teknik ne ndertim si me poshte:

Te plotesohen kerkesat higjeno sanitare per punetoret dhe mjetet ne objekt.

Nga kontraktori duhet te sigurohen mjetet mbrojtese kolektive dhe individuale si veshmbathje, mjete mbrojtje, etj.

Te behet instruksioni teknik i sigurimit te punonjesve sipas proceseve te punes qe kryhen ne objekt.

Ne objekt duhet te mbahet rregullorja e sigurimit teknik dhe protokollet per instruksionet e dhena nga personeli inxhinjero teknik.

Te punohet sipas plan organizimit te punimeve per cdo nenobjekt sipas grafikut te percaktuar ne kontrate.



ANGERBA SHPK

Te instruktohen drejtuesit e makinerive meqenese punohet ne zona te banuara, paraprakisht te bejne kontrollin e terrenit ku kalojne linjat me qellim qe te mbrohen nga renia ne tension ose demtimi i punimeve te maskuara te infrastruktures ekzistuese.

Per me hollesisht kontraktori duhet te zbatoje Rregulloren e Sigurimit Teknik per punen ne ndertim, dhene nga ISTN-ja ne Shtator 2000.

VI.- AFATI I KRYERJES SE PUNIMEVE

Projekti parashikon qe per kryerjen e punimeve per objektin **“Rikonstruksion i Shkarkuesit Katastrofik Malaj-1”** nevojitet nje afat prej 3 muaj. Menyra e kryerjes se punimeve jepet ne grafikun e punimeve bashkelidhur raportit teknik.

VII.- ORGANIZIMI I PUNIMEVE

Për ndërtimin e objektit: **“Rikonstruksion i Shkarkuesit Katastrofik Malaj-1”** projekti parashikon të përdoren materiale të cilësisë së lartë sipas standarteve të vendit dhe ndërkombëtare dhe të zbatohen me rigorozitet Kushtet Teknike të Zbatimit të punimeve. Betonet jane parashikuar te prodhohen me betoniere ne vend por edhe mund te merren tek fabrikat e betonit si beton me i garantuar.

Gjate ndertimit të këtij objekti të kihet parasysh gjithashtu:

- 1.- Betonet janë parashikuar të jenë të markës C 16/20 dhe C 20/25.
- 2.- Të gjitha betonet janë parashikuar të formohen me betonforma.
- 3.- Nuk do të hidhet beton pa përdorur vibratorin.

Materialet e objektit do te merren ne prodhuesit qe plotesojne kerkesat e specifikimeve teknike.

Materialet inerte per betonet do te merren ne nyjet e fraksionimit qe ndodhen ne afersi te zones.

VIII.- PREVENTIVI

Preventivi eshte vleresuar me çmimet e marra nga Sistemi i Integruar për Informatizimin e Manualit të Çmimeve për Zërat e Punimeve në Ndërtim, VKM Nr.216, date 13.04.2023 dhe vlera e plote eshte **12 000 000** leke me TVSH

“ANGERBA”shpk

Ing.Burhan HAFIZI

